

## Syllabusi i lëndës – Bazat e Ekonomisë

<b>Të dhëna bazike të lëndës: Syllabusi</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Bazat e Ekonomisë</b>
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës:</b>	E rregullt
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti parë (I), semestri i dytë (II)
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+2
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	5 ECTS
<b>Koha / lokacioni:</b>	Rr. “Bill Clinton” p.n., 10000 Prishtinë, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Dr. Sc. Njazi Bytyqi, Prof. Asoc. Departamenti i Agro ekonomisë Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë Universiteti i Prishtinës
<b>Detajet kontaktuese:</b>	Emali: <a href="mailto:njazi.bytyqi@uni-pr.edu">njazi.bytyqi@uni-pr.edu</a> Nr. Tel: +38345500033
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Në programin e kësaj lëndë, studentët do të gjejnë informacionin e nevojshëm për një numër problemesh që lidhen me:</p> <p>Ekonomiksin - Detyrimi social që ka çdo qeveri si dhe çdo sistem ekonomik për zgjidhjen e problemit kryesor global, Pamjaftueshmërisë. Nevojën e krijimit të shkencës ekonomike dhe zbatimin e saj, si dhe fushat ku kjo është aplikuar me kalimin e dekadave.</p> <p>Mikroekonominë - Mikroekonomia dhe të gjitha ndërvarësitë e tregut dhe agjentëve ekonomikë. Si reagojnë tregu dhe agjentët ekonomikë ndaj faktorëve kryesor që orientojnë zgjedhjet individuale dhe kolektive.</p> <p>Makroekonominë - Ndërveprimi i ekonomive të mëdha si dhe mënyra si ato operojnë duke ndërhyrë ose mos ndërhyrë në treg. Politikën e ndryshme socio-ekonomike dhe aplikimi i tyre, historik dhe aktual.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Nëpërmjet programit të lëndës Bazat e Ekonomisë, studentët do të fitojnë aftësitë dhe informacionin e nevojshëm që:</p> <p>Të analizojë sjelljen e një firme në funksion të minimizimit të kostos duke përdorur analizën grafike dhe krahasuese;</p> <p>Të njohë analizën ekonomike të firmës, duke përqendruar vëmendjen në përcaktimin dhe</p>

	<p>mënyrat e llogaritjes se treguesve te ndryshëm te kostos;</p> <p>Të njohë qasjet “dështim tregu” të rolit qeveritar dhe perspektivat alternative të rolit të qeverisë;</p> <p>Të përkufizojë funksionin e mirëqenies sociale dhe rëndësinë e tij për ekonomistët dhe të mendojë sistematikisht lidhur me efikasitet dhe pabarazinë;</p> <p>Të analizoje kostot ne përshtatje me funksionin e prodhimit, për periudha afat-shkurtra dhe periudha afat-gjata;</p> <p>Të njihet mbi veprimtarinë e shtetit ne sferën ekonomike;</p>
<p><b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b></p>	<p>Nëpërmjet programit të lëndës studentët do të gjejnë informacionin e nevojshëm për një numër çështjesh të lidhura me:</p> <p>Të kuptojë se çka është shkenca ekonomike, cila është përmbajtja, qëllimi dhe objekti i studimit të saj;</p> <p>Të mësojë t’i trajtojë këto probleme në mënyrën formale të përdorur nga ekonomistët nëpërmjet lakores së kufirit të mundësive të prodhimit dhe të dalloje rolin e ekonomisë se tregut ne zgjidhjen tyre;</p> <p>Të kuptojë se si zgjedhjet e konsumatorit u nënshtrohen parimeve te zgjedhjes racionale;</p> <p>Të kuptojë rolin e rëndësishëm të kërkesës dhe ofertës si mjete të analizës së dukurive ekonomike ne një ekonomi tregu;</p> <p>Të përshkruaj përcaktuesit kryesor të kërkesës dhe ofertës, se çfarë e zhvendos lakoren e kërkesës dhe të ofertës;</p> <p>Te njoh veçoritë e tregjeve ne te cilat vepron një firme, pasi ato ndikojnë ne një mase te rëndësishme ne vendimet e firmës lidhur me sasinë e prodhimit, çmimet etj.</p> <p>Të kuptojë se çfarë është paraja dhe se si ndërtohet një sistem i vërtetë monetar;</p> <p>Të kuptojë se si Banka Qendrore ndikon në ofertën e parasë. Duke e kombinuar këtë me kërkesën për para, te analizuar ne leksionet e mëparshme, të vlerësojë ekuilibrin e tregut te parasë.</p> <p>Të analizojë dhe te llogarisë tregues si : Treguesit e mirëqenies, Prodhimi i Brendshëm Bruto, Rritja Ekonomike dhe Ciklet e Biznesit me qëllim te</p>

	<p>japi kuptimin makroekonomik te veprimit të ekonomisë si një e tërë;  Të përcaktojë qëllimet e politikave makroekonomike dhe instrumentet e realizimit të tyre;  Të fillojë të ndërtojë për herë të parë një model makroekonomik që do të shërbejë për analiza të mëtejshme makroekonomike, koncepte baze: Kërkesën Agregate, Ofertën Agregate dhe Ekuilibrin Makroekonomik, GDP-se, ciklet e biznesit, papunësinë dhe inflacionit.  Të njohë rëndësinë e marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare.</p>		
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Javë</b>	<b>Gjithsejtë/orë</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	-	-	-
Punë praktike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	3	6
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume, seminare	1	3	3
Detyra të shtëpisë	2	3	6
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	3	6	18
Projektet, prezantimet, etj	2	11	22
<b>Totali</b>			<b>160</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Metodologjia e mësimdhënies bazohet në ligjërime, ushtrime, teste të vlerësimit (2) dhe punë seminarike, detyra, në bazë të mundësive edhe praktik në teren.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Studentet duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë njohuritë e fituara gjatë kursit. Vlerësimi i studentëve si më poshtë. Vlerësimi i parë: 35% Vlerësimi i dytë: 35%		

	Detyrat e shtëpisë dhe angazhime tjera 15% Vijimi i rregullt 15% Total 100%
<b>Literatura bazë:</b>	<b>Literatura e obliguar:</b> 1. Hyrje ne Ekonomi”, A. Mancellari, S. Haderi, Dh. Kule, S. Qirici 2007 dhe 2010;
<b>Literatura shitesë:</b>	<b>Literaturë Shtesë:</b> 1. Economics - Sixth Edition” D. Begg, S. Fisher, R. Dornbusch 2004; 2. Microeconomics: People are Different” J.D. Hey 2003 nga McGraw-Hill; 3. Economics”, Jocelyn Blink, Ian Dorton, Oxford University Press, Publikimi i pare 2007.
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	
<b>Java e parë:</b>	<b>Ekonomiksi. Vështrimi i përgjithshëm mbi shkencën Ekonomike. Parimet e Ekonomisë</b> (Parimet e ekonomisë, Vendimet individuale, Bashkëveprimi ndërmjet individëve, Funksionimi i ekonomisë ne tërësinë e vet, faktorët e prodhimit, ndarja e ekonomisë - Mikroekonomia dhe Makroekonomia. Ekonomiksi).
<b>Java e dytë:</b>	<b>Mikroekonomia. Kërkesa. Oferta. Faktorët Përcaktues. Ekuilibri i Tregut</b> (Dimensionet e tregut, Kërkesa, lakorja e kërkesës. Kërkesa e tregut dhe kërkesa individuale, Oferta. Lakorja e ofertës, raporti ndërmjet çmimit dhe sasisë se ofruar, Oferta e tregut dhe oferta individuale, Zhvendosjet e lakores se ofertës, Bashkëveprimi ndërmjet lakores se ofertës dhe kërkesës. Ekuilibri, Disekuilibri, Analiza e ndryshimit te ekuilibrit. Zhvendosja e lakores dhe ndryshimit te ofertës dhe kërkesës).
<b>Java e tretë:</b>	<b>Elasticiteti i Kërkesës dhe Ofertës. Faktorët përcaktues</b> (Elasticiteti i kërkesës. Elasticiteti i kërkesës lidhur me çmimin dhe faktorët përcaktues te tij, Llogaritja e elasticitetit te kërkesës ne lidhje me çmimin, Llojet e lakores së kërkesës, E ardhura totale dhe elasticiteti i kërkesës ne lidhje me çmimin, Lloje te tjera te elasticitetit te kërkesës, Elasticiteti i ofertës. Elasticiteti i ofertës ne lidhje me çmimin dhe faktorët përcaktues te tij, Llogaritja e elasticitetit te ofertës, Shembull i zbatimit te elasticitetit te kërkesës dhe ofertës).
<b>Java e katërt:</b>	<b>Roli i Konsumatorit në Ekonominë e Tregut. Konsumi dhe Kursimi. Sjellja Blerëse e Konsumatorëve. Dobia e Konsumatorëve</b> (Konsumatori ne fokus, Kufiri i bilancit: ajo qe konsumatori mund ti lejoje vetes, Preferencat: ato qe

	konsumatori dëshiron të blej dhe konsumojë, Optimizimi: ajo që zgjedh konsumatori, Zgjedhja optimale e konsumatorit, Efekti i ndryshimit të ardhurave në zgjedhjet e konsumatorit, Efektet e ndryshimit të çmimit në zgjedhjen konsumatorë, Efekti i të ardhurave dhe efekti i zëvendësimit).
<b>Java e pestë:</b>	<b>Firmat (ndërmarrja, biznesi). Llojet e Firmave dhe zgjerimi i tyre. Kapitali i Firmave</b> (Firma dhe objektivat e saj, Firmat dhe tregjet, Llojet e firmave, Rrugët e rritjes së kapitalit nga firmat, Kontabiliteti i firmës. Bilanci dhe pasqyra e rezultatit financiar).
<b>Java e gjashtë:</b>	<b>Kosto. Teoria e Kostos. Llojet e Kostove. Sjellja e Kostove në periudha afatshkurtra dhe afatgjate</b> (Kostot në periudha afatshkurtra, Kosto oportune, Kosto në periudha afatgjata).
<b>Java e shtatë:</b>	<b>Testi i parë (I)</b>
<b>Java e tetë:</b>	<b>Makroekonomia. Tregjet e faktorëve të prodhimit. Tregu i Punës, Papunësia dhe Punësimi, Ekuilibri. Kapitali, Tregu i Tokës, Renta, Efekti i taksës së Tokës</b> (Objektivat Makroekonomike, Instrumentet kryesore politike (makroekonomike), Kërkesa e punës, Ndërmarrja konkurrenciale që dëshiron të maksimizojë fitimin, Funkcioni i prodhimit dhe kërkesa e punës, Faktorët që mund të shkaktojnë zhvendosjen e lakores së kërkesës dhe ofertës së punës, Oferta e punës, Raporti i këmbimit ndërmjet punës dhe kohës së lire, Ekuilibri në tregun e punës, Faktorët e tjerë të prodhimit: toka dhe kapitali, Ekuilibri në tregjet e tokës dhe të kapitalit, Lidhjet ndërmjet faktorëve të prodhimit).
<b>Java e nëntë:</b>	<b>Tregu i Kapitalit Financiar. Normat e Interesit. Vlera e kohës së Parasë. Paraja dhe Institucionet Financiare. Sistemi Bankar. Bankat. Llojet e tyre dhe Produktet e tyre</b> (Paraja dhe Sistemi Bankar modern (Banking), Çfarë është paraja dhe ndërtimi i një sistemi të vërtetë monetar, Koncepti i parasë, natyra dhe funksionet e parasë në një ekonomi moderne monetare, Normat e Interesit, Roli i Bankës Qendrore dhe si ndikon ajo në tregjet financiare. Si Banka qendrore ndikon në ofertën e parasë.
<b>Java e dhjetë:</b>	<b>Tregu i Konkurrencës së Plotë (tregu i lirë). Llojet e tjerë të tregjeve dhe ndryshimi midis tyre</b> (Tregu i konkurrencës, Kuptimi i konkurrencës, Te ardhurat e një ndërmarrjeje në konkurrencën e plotë, Maksimizimi i fitimit dhe lakorja e ofertës të ndërmarrjes në konkurrencën e plotë, Monopoli, konkurrenca e kufizuar monopolistike, Oligopoli. Marrëveshjet e fshehta etj.).

<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	<b>Treguesit e Mirëqenies. Prodhimi i Brendshëm Bruto. Rritja Ekonomike. Punësimi. Papunësia. Ciklet e Biznesit</b> (Te ardhurat dhe shpenzimet e sistemit ekonomik, Matja e produktit të brendshëm bruto (GDP), GDP real dhe GDP nominal, GDP dhe mirëqenia sociale, Rritja ekonomike në botë, Produktiviteti, Punësimi dhe llojet e punësimit. Papunësia, Rritja dhe politike ekonomike, Rëndësia e kursimit dhe investimeve. Ciklet e biznesit).
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<b>Kërkesa dhe Oferta Agregate (Përgjithshme). Ekuilibri Makroekonomik</b> (Lakorja e kërkesës dhe ofertës agregate në periudha farëshkurtra dhe afatgjata, Efektet e zhvendosjes së kërkesës agregate, Efektet e zhvendosjes të ofertës agregate, Ekuilibri makroekonomik).
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	<b>Inflacioni. Shkaqet dhe pasojat e Inflacionit</b> (Teoria klasike e inflacionit, Niveli i çmimeve dhe vlera e parasë, Oferta e parasë, kërkesa e parasë dhe ekuilibri monetar, Efektet e një injeksioni, Llojet e Inflacionit).
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	<b>Marrëdhëniet Ekonomike Ndërkombëtare. Bilanci i Pagesave. Tregu Valutor dhe kursi i këmbimit</b> (Fluksi ndërkombëtar i mallrave dhe i kapitalit, Fluksi i të mirave dhe ekporti neto, Fluksi i aktivitetit financiar: fluksi neto i kapitalit, Kursimi investimet dhe raporti i tyre me flukset ndërkombëtare, Çmimet e transaksioneve ndërkombëtare, Kursi real i këmbimit, Oferta dhe kërkesa e fondeve të huase dhe e valutës së huaj, Tregu i fondeve të huase, Tregu i këmbimit valutor, Ekuilibri në ekonominë e hapur, Deficiti publik, Politikat tregtare, Paqëndrueshmëria politike dhe largimi i kapitalit).
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<b>Testi i dytë (II)</b>
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<p>Suksesi i studentit në këtë kurs do të varet nga zhvillimi i vetë disiplinës. Rregullat e mëposhtme do të ndihmojnë për të siguruar përvojën e të nxënësve për të gjithë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Nxënësve nuk u lejohej të hanë ose pinë në klasë gjatë orës së mësimi.</li> <li>– Të gjitha pajisjet elektronike dhe telefonat celularë duhet të çaktivizohen gjatë orës (nëse nuk kërkohet nga mësuesi).</li> <li>– Nxënësit duhet të ndjekin udhëzimet e mësuesve gjatë gjithë mësimi dhe të mos flasin pa leje.</li> <li>– Studentëve u kërkohet të marrin pjesë në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt në të gjitha leksionet dhe ushtrimet dhe që nga dita e parë e fillimit të orës do të mbajnë evidencë për vijimin e mësimi.</li> <li>– Do të ketë një dokument me shkrim për çdo mashtrim ose pandershmeri gjatë ligjëratave, ushtrimeve dhe provimeve.</li> </ul>	